



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA BULQIZE
KESHILLI BASHKIAK

Adresa: Lagja "Minatori"

email: bashkiabulqize@hotmail.com

V E N D I M

NR 27 DATE 28/2 /2018

Per

"Miratimin e kërkeses së Bashkisë Bulqize, së bashku me dokumentacionin ligjor për akordimin e ndihmës financiare për riabilitimin e rruges në Lagjen "Gjeologu", Bashkia Bulqize e cila është demtuar nga reshjet rena në periudhën Nëntor-Dhjetor 2017 nga buxheti i Bashkisë dhe buxheti i vitit 2018 në Ministrinë e Punëve të Brendshme, programi "Emergjencat Civile".

BAZA LIGJORE :

Ligji 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligji Nr. 107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", Ligji Nr. 8756, datë 26.03.2001 "Për Emergjencat Civile", i ndryshuar, VKM Nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhenies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", ", **Keshilli Bashkiak në mledhjen e tij të datës 28.02.2018 pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Emergjencave Civile dhe Rrugeve Rurale, me 15 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim**

V E N D O S I :

1. Te miratojë kërkesën e Bashkisë Bulqize për mbështetje financiare për rrugën e demtuar të Lagjes "Gjeologu", Bashkia Bulqize për demtimin e saj nga reshjet e rena.
2. Te miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Bulqize, dhe vlerën e dëmit të shkaktuar: 117.279 .(njqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e nente) leke dëme.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme për ndihmë financiare, për shkak të pamundësisë së Bashkisë Bulqize për të mbuluar vlerën financiare të riparimit të dëmit të shkaktuar.

4.Ndihma financiare qe do te akordohet do te perdoret per rehabilitimin e rruges ne Lagjen "Gjeologu", Qyteti i Vjeter Bashkia Bulqize

Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Diber.


SEKRETARI
Agim TUCI



PER KESHILLIN BASHKIAK



KRYETARI
Gazmend KENGA



Dixhitalizuar ne kuader te projektit STAR II permes Qendres per Çeshtjete Informimit Publik
www.infocip.org
www.vendime.al